**V E N D I M**

**Nr.339, datë 6. 6. 2018**

**PËR**

**KRITERET DHE MËNYRËN E NDARJES SË ÇMIMIT “AMBASADOR I KOMBIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Përcaktimin e kritereve dhe të mënyrës së ndarjes të çmimit “Ambasador i Kombit”.

2. Ndarja e çmimit “Ambasador i Kombit” udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës, mirënjohjes publike. Kriteret, që duhet të plotësojnë pjesëtarët e suksesshëm të diasporës për marrjen e çmimit, janë:

a) integriteti dhe reputacioni në komunitetin ku ai/ajo jeton;

b) përfaqësimi i suksesshëm në diasporë në:

- veprimtari humanitare;
- arsim, shkencë, teknologji;
- kulturë apo sport;
- biznes.

b) kontributi i veçantë për Republikën e Shqipërisë apo diasporën.

3. Ambasadorët e Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për punët e jashtme, i propozojnë ministrit përgjegjës për diasporën përfaqësuesit më të suksesshëm tëkomuniteteve shqiptare jashtëvendit për dhënien e çmimit “Ambasador i Kombit”.

4. Propozimet duhet të shoqërohen me biografinë dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së subjektit të propozuar.

5. Ministri përgjegjës për diasporën vlerëson propozimet e ardhura, së bashku me rekomandimet për dhënien e çmimit, dhe ia propozon ato, zyrtarisht, Kryeministrit.

6. Çmimi “Ambasador i Kombit” jepet nga Kryeministri.

7. Çmimi “Ambasador i Kombit” i dorëzohet personalisht personit që merr çmimin, por, në raste të veçanta, mund t’i dorëzohet edhe familjarëve apo përfaqësuesve të tij.

8. Çmimi “Ambasador i Kombit” nuk ka vlerë monetare.

9. Çmimi “Ambasador i Kombit” jepet në formën e një certifikate.

10. Forma e certifikatës “Ambasador i Kombit” është sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Përjashtimisht, për raste të veçanta, propozimi për çmimin “Ambasador i Kombit” mund të bëhet drejtpërdrejt nga ministri përgjegjës për diasporën, në përputhje me këtë vendim, dhe, në këtë rast, nuk do të zbatohet parashikimi i pikës 3.

12. Ngarkohen ministri përgjegjës për diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**